



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURES  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 463 Prot.

Tiranë, më 03.04 2018

**VENDIM Nr. 73, datë 20.03.2018**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Bylis"2018*, në kuadër të Shkollës Doktorale të Arkeologjisë, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike) drejtues Prof. Dr. Luan Përzhita dhe MA. Olgita Ceka, në bashkëpunim me Fakultetin e Arkitekturës të Universitetit Politeknik të Tiranës, paraqitur nga Instituti Arkeologjisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Bylis"2018*, në kuadër të Shkollës Doktorale të Arkeologjisë, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike) drejtues Prof. Dr. Luan Përzhita dhe MA. Olgita Ceka, në bashkëpunim me Fakultetin e Arkitekturës të Universitetit Politeknik të Tiranës, paraqitur nga Instituti Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
  - Përditësim i dokumentacionit, rikonstruksioni 3D i monumenteve të Bylisit, të gërmuara gjatë viteve 1978- 1990 dhe vazhdimi i dokumentimit në sternën e stadiumit;
  - Përditësimi i dokumentacionit grafik të monumenteve të agorasë së qytetit antik, si modeli më i realizuar i organizimit të hapësirës sociale në një qytet ilir, në territorin e Shqipërisë;
  - Dokumentimi i plotë i sternës së stadiumit pjesërisht të gërmuar dhe ende të pastudiuar pas ndërprerjes së gërmimeve në fjalë.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë



Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)

2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2018.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO

